HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

INTEGRITETI AKADEMIK DHE PUBLIKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E PEJËS



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Autor i përmbajtjes:
Skord Retkoceri
Rron Gjinovci

Hartues i raportit:
Rron Gjinovci

Prishtinë, Korrik 2025

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit.
Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

5 **Përmbledhje ekzekutive**

6 **Të dhënat për universitetin**

7 **Publikimi shkencor**

10 Në cilat kuartale të Scopus-it publikuan stafi?

12 Vendet nga ku janë botuesit e revistave

15 Punimet e vlefshme për avancim

17 **Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë**

18 **Justifikimi i titujve akademikë**

21 **Metodologjia**

Përmbledhje Ekzekutive

Kjo faqe është gjeneruar me ChatGPT: Gjenero një përmbledhje ekzekutive të raportit hulumtues të bashkangjitur, bazuar në të dhënat e paraqitura. (max. 350 fjalë)

Ky raport analizon në thellësi përbërjen dhe performancën akademike të stafit të Universitetit të Pejës, me theks në integritetin akademik dhe publikimin shkencor. Universiteti përfshin 74 anëtarë të stafit akademik në katër fakultete, nga të cilët 63 mbajnë tituj profesorialë. Struktura gjinore është 58% burra dhe 42% gra, me trend pozitiv të përfshirjes së grave në pozita akademike më të ulëta, çka sinjalizon për një rritje të mundshme të përfaqësimit të tyre në të ardhmen.

Stafi ka publikuar 309 punime në revista të indeksuara në Scopus, prej të cilave 43 janë të indeksuara edhe në Web of Science. 88% e këtyre publikimeve janë bërë pas vitit 2018, që përkon me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ për avancime akademike. Megjithatë, 12% e publikimeve janë bërë në revista që më pas janë përjashtuar nga Scopus për mungesë cilësie.

Rreth 28% e punimeve janë botuar në revista të kuartalit të parë dhe të dytë të Scopus, duke treguar një nivel të kënaqshëm të cilësisë shkencore. Megjithatë, 27% i përkasin kuartalit të katërt, që konsiderohet më pak cilësor. Pesë revista të vetme përmbajnë 31% të gjithë publikimeve, duke reflektuar një përqendrim të lartë dhe një mungesë diversiteti në publikim.

Nga 309 punime, 252 janë të vlefshme për avancim akademik. 51 prej tyre kanë autorë të parë dhe korrespodent nga stafi, çka nënkupton që dy persona mund t'i përdorin për avancim. Vetëm 4 nga 63 profesorët nuk kanë asnjë punim të vlefshëm. Fakulteti i Agrobiznesit prin me 4.1 punime për anëtar stafi.

Në përgjithësi, 79% e profesorëve në Universitetin e Pejës justifikojnë titujt e tyre akademikë. Ky është një përmirësim i madh krahasuar me vitin 2020 kur vetëm 30% e justifikonin titullin. Gratë performojnë më mirë se burrat në këtë aspekt (92% ndaj 72%), duke treguar si efektet e një zbatimi më strikt të kritereve, ashtu edhe potencialin për barazi dhe ekselencë të qëndrueshme në të ardhmen.

Të dhëna për universitetin

Universiteti i Pejës ka 74 pjesëtarë të stafit akademik në 4 njësi akademike sa ka gjithsejt. 17 janë profesorë të rregullt, 18 profesorë të asocuar, 28 profesorë asistentë, pra gjithsejt 63 pjesëtarë të stafit akademik me tituj profesorialë dhe 11 asistentë.

Numri i stafit akademik sipas fakulteteve

	Profesorët e rregullt	Profesorët e asocuar	Profesorët asistentë	Asistentë	Total staf
Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit	4	2	7	1	**14**
Fakulteti i Biznesit	7	6	13	7	**33**
Fakulteti i Agrobiznesit	3	6	6	2	**17**
Fakulteti Juridik	3	4	2	1	**10**
Të gjitha fakultetet	**17**	**18**	**28**	**11**	**74**

Universiteti i Pejës ka 43 burra si pjesëtarë të stafit akademik dhe 31 gra pjesëtare të stafit akademik, shprehur në përqindje si 58% burra dhe 42% gra, çka përbën një strukturë gjinore të pëlqyeshme për situatën gjinore të institucioneve publike të Kosovës.


Në thirrjen e fundit akademike, atë të profesorit të rregullt janë vetëm 3 gra në krahasim me 14 burra, ngjashëm në atë të profesorit të asocuar 5 gra dhe 13 burra, ndërkaq raporti përmbyset te profesori asistent ku shumica janë gra, pra 16 gra dhe 12 burra. Kjo tregon se në punësimet e reja të stafit akademik i është kushtuar kujdes përfshirjes gjinore dhe se paragjykimet patriarkale të së kaluarës për gratë në akademi janë zbehur ndjeshëm. Po ashtu në radhët e asistentëve janë 7 gra dhe 4 burra, çka tregon se emërimet e ardhshme në tituj profesorialë mund të vazhdojnë trendin e rritjes së numrit të grave në mesin e pjesëtarëve të stafit akademik.

Përbërja e stafit sipas gjinisë

	Profesorët e rregullt	Profesorët e asocuar	Profesorët asistentë	Ligjërues	**Total**	
Gra	0	2	5	2	**9**	**25%**
Burra	2	10	9	6	**27**	**75%**
Total	**14**	**14**	**2**	**8**	**36**	**100%**


Publikimi shkencor

Stafi akademik (profesorët dhe asistentët) kanë publikuar 309 punime shkencore në revista të indeksuara në Scopus. Prej tyre 43 apo 14% e tyre janë tw indeksuara edhe në Web of Science, ndërsa 266 punime apo 86% janë në revista të indeksuara vetëm në Scopus. Këtu nuk përfshihen punimet në revistat apo botues që janë të listuar si të dyshimtë apo komunikimet e shkurta apo komunikimet preliminare (short communication, preliminary communcation etj.), 11 të tilla.




Punimi i parë i evidentuar i një pjesëtari të stafit aktual akademik është i vitit 2010. Një trend rritës dhe domethënës vërehet nga vitit 2021 i cili nga viti në vit është shënuar me rritje dyshifrore të shprehur në përqindje. Mund të thuhet se shumica dërrmuese e të gjitha punimeve të Universitetit të Pejës vijnë në periudhën pas vitit 2018 kur edhe vendoset udhëzimi i parë administrativ që përcakton platformat indeksuese të revistave shkencore që pranohen në Kosovë për avancime akademike. 88% të të gjitha punimeve të publikuara në revista të indeksuara në Web of Science dhe Scopus nga stafi akademik aktual i Universitetit të Pejës, janë në periudhën 2019 – 2024. Ky udhëzim i cili ende është në fuqi është i 1 janarit 2018 i nënshkruar nga Ministri i atëhershëm Shyqiri Bytyqi. Ndonëse udhëzimi parashihte edhe 3 platforma tjera të listimit dhe indeksimit të revistave përveç Web of Science dhe SCOPUS, rregullativa e shumicës së universiteteve publike, e po ashtu ajo e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, njohin vetëm këto dy platforma. Deri në korrik të vitit 2025, ky udhëzim nuk ka ndryshuar dhe shërben vetëm si standardi më i ulët mbi të cilin universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë mund të ndërtojnë rregullativën e tyre të publikimit akademik.

Numri i punimeve shkencore në Universitetin e Pejës sipas viteve



Numri total i punimeve në Universitetin e Pejës përgjatë viteve




Prej 309 punimeve, 38 apo 12% janë në revista të larguara nga indeksimi në Scopus në vite të ndryshme. 30 anëtarë të stafit apo 41% kanë publikuar në revista të tilla. Revistat largohen nga Scopus nëse pas një rivlerësimi periodik vërehen probleme me cilësinë e përmbajtjes, mungesë të praktikave të besueshme editoriale apo shkelje të standardeve etike të publikimit.

Revista ku ndodhet punimi	Viti i publikimit të punimit	Viti i fundit i indeksimit në Scopus
PONTE	3 punime - 2016	2017
International Journal of Economic Perspectives	1 punim - 2017	2018
European Research Studies Journal	1 punim - 2018	2018
International Journal of Economics and Business Administration	4 punime – 2019 5 punime - 2020	2020
Informatologia	2 punime - 2018	2021
Oriental Journal of Chemistry	1 punim - 2018	2021
Review of International Geographical Education Online	1 punim - 2021	2021
Journal of Survey in Fisheries Sciences	1 punim – 2018 1 punim – 2023	2023
Journal of Liberty and International Affairs	1 punim – 2019	2023
Journal of Hygienic Engineering and Design	1 punim – 2021 6 punime – 2022 4 punime – 2023	2023
International Journal of Emerging Technologies in Learning (iJET)	2 punime – 2022	2023
International Journal of Instruction	1 punim – 2022	2023
International Journal of Professional Business Review	1 punim – 2022	2023
Journal of Eastern European and Central Asian Research	1 punim – 2023	2024
Nurture	1 punim – 2024	2024
Revista de Gestão Social e Ambiental	1 punim – 2024	2024
Journal of Management World	1 punim – 2024	2024


Në cilat kuartale të SCOPUS-it janë revistat ku publikoi stafi akademik i Universitetit të Pejës?

Kualiteti i revistave të indeksuara në Scopus, në të cilat publikon stafi akademik i universiteteve publike tregohet përmes rangimit të tyre në kuartale indeksimi. Kuartali i parë dhe i dytë garantojnë cilësi, ndërkaq i treti dhe i katërti nuk janë garantues të cilësisë meqë në të kaluarën vet ORCA ka adresuar probleme të praktikave të dyshimta të revistave të indeksuara në Scopus të cilat pas denoncimeve të ORCA-s ose janë larguar nga indeksimi në Scopus ose janë futur në listën e zezë të universiteteve pubike.

Numri i publikimeve sipas kuartaleve në Scopus



28% të punimeve të publikuara në revista të indeksuara në SCOPUS i takojnë kuartalit Q1 dhe Q2, çka e bën të kënaqshëm portretin e kualitetit të publikimeve në Universitetin e Pejës.



Kuartalet dhe ndërlidhja me Web of Science

Rëndom, revistat e indeksuara në Scopus në kuartalet një dhe dy, janë të indeksuara edhe në Web of Science, çka e rritë garancinë e kualitetit të tyre të procesit “peer review”. Mund të ndodhë që edhe revistat e e kuartalit të tretë të kenë indeksim në Web of Science, por ndodh rrallë apo fare që revistat e kuartalit të katërt. Si rrjedhojë edhe ndërprerja e indeksimit nga Scopus ndodh zakonisht me revistat e indeksuara në kuartalin e katërt. Siç mund të vërehet nga të dhënat 27% të të gjitha punimeve të stafit akademik të Universitetit të Pejës të indeksuara në Scopus i takojnë kuartalit të katërt.


	Numri i punimeve në Scopus	Prej tyre në Web of Science
Kuartali 1	20	13
Kuartali 2	66	12
Kuartali 3	102	7
Kuartali 4	83	8
Pa kuartal*	38	3

* Punimet e larguara nga Scopus nuk janë në asnjë kuartal


Shtetet nga ku janë botuesit e revistave

Stafi akademik në këtë universitet ka publikuar në revista nga 32 shtete të ndryshme. 15% e punimeve janë në revista të një shteti të vetëm, pra në Poloni. Fokusi i publikimit në shtete dhe revista të caktuara është shenjë e bashkëpunimit të brendshëm të stafit në identifikimin dhe synimin për publikim në revista ku tashmë ndokush nga stafi ka publikuar.


Vendet nga ku janë botuesit e revistave - 20 vendet e para



Shtetet e botës nga ku janë botuesit e revistave ku kanë publikuar stafi në Universitetin e Pejës



Shtetet e Evropës nga ku janë botuesit e revistave ku kanë publikuar stafi në Universitetin e Pejës



31%, apo 95 nga 309 punimet e publikuara të pjesëtarëve të stafit akademik në Pejë janë publikuar në 5 revistat e listuara në këtë raport. Siç mund të vërehet vetëm njëra nga to i takon kuartalit 2, pra që ka një kualitet më të garantuar ndërkaq të tjera i takojnë kuartaleve 3 dhe 4.

Koncentrimi i publikimit në revista të caktuara apo edhe shtete të caktuara mund të jetë rrezik për rangimin e universitetit në të ardhmen në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare të rangimit. Mundësia që një revistë ku mund të ketë koncentrim të madh publikimesh të përjashtohet nga indeksimi apo të përballet me ndonjë problem të ngjashëm, është reale dhe si rrjedhojë do të mund të shkaktojë probleme.


Diversifikimi i publikimit nga stafi akademik i universiteteve publike rritë mundësinë për bashkëpunim dhe shkëmbim ndërkombëtar çka është një nga indikatorët e cilësisë së një universiteti në shekullin 21.

5 revistat ku stafi ka publikuar më së shumti punime

	Emri i revistës	Numri i punimeve	Vendi	Kuartali në Scopus
1	Quality-Access to Success	29	Romani	Q4
2	Ecological Engineering & Environmental Technology	17	Poloni	Q3
3	Human Research in Rehabilitation	17	Bosnje dhe Hercegovinë	Q4
4	Journal of Ecological Engineering	17	Poloni	Q2
5	International Journal of Sustainable Development & Planning	15	Mbretëri e Bashkuar	Q3

Punimet e vlefshme për avancim

Prej 309 punimeve, 252 punime janë të publikuara në revista të indeksuara nw Web of Science dhe SCOPUS dhe mund të përdoren për avancim akademik. Të gjitha janë të indeksuara në Scopus, 32 prej tyre apo 13% janë edhe në Web of Science.




51 prej punimeve, apo 20%, kanë të dy, si autorin e parë ashtu edhe autorin korrespodent, nga stafi akademik i universitetit, që do të thotë se të dy mund t'i përdorin këto punime për avancim akademik.

Shtrirja e numrit të punimeve nëpër stafin akademik të Universitetit të Pejës tregon për një qëndrueshmëri në trendet rritëse të publikimit shkencor që ka pasë në 7 vitet e fundit ky Universitet. Prinë Fakulteti i Agrobiznesit me një numër domethënës punimesh prej 4.1 punime për kokë stafi akademik. Në përgjithësi në Universitetin e Pejës, po të merret mesatarja e 3.5 punimeve për kokë stafi akademik del se pjesëtarët e stafit akademik të Universitetit të Pejë kanë përgatitjen e profesorit të asocuar sa i përket numrit të publikimeve shkencore. Natyrisht, janë edhe shumë faktorë tjerë të cilët për hir të këtij krahasimi janë lënë jashtë llogaritjes. Vetëm 4 nga 63 profesorë nuk e kanë asnjë punim të vlefshëm për avancim akademik, pra si autor i parë ose korrespodent. 2 prej tyre nuk figurojnë si autor në asnjë punim shkencor, në çfarëdo radhe.

Numri i punimeve të vlefshme për avancim akademik sipas fakulteteve

	Numri i stafit akademik	Numri i punimeve	Numri i punimeve për një anëtarë stafi
Fakulteti i Agrobiznesit	17	70	4.1
Fakulteti i Biznesit	33	98	3
Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit	14	55	3.9
Fakulteti Juridik	10	39	3.9
Të gjitha fakultetet	**74**	**262***	**3.5**

** Ky numër në kuptim të këtij kapitulli nuk e tregon vlerën absolute të punimeve që ekzistojnë të publikuara i cili është 252 punime. Duke qenë se në 51 punime autorët janë kolegë në cilësinë e autorit të parë dhe korrespodent dhe të dy kanë të drejtë ta përdorin të njëjtin punim në avancim akademike, për më tepër 10 prej punimeve, autorët janë kolegë nga fakultete të ndryshme në cilësinë e autorit të parë dhe korrespodent, numri 262 nuk është vlerë absolute e punimeve por vlerë relative që tregon sa herë janë numëruar punimet për avancime. Në kapitullin e këtij raporti "Publikimi Shkencor" numri absolut i punimeve është 252 dhe paraqet numrin e publikimeve ekzistuese të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare. Ndërkaq numri 262 paraqet numrin e punimeve në raport me pozitat profesoriale.*




Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë

Stafi akademik në Universitetin e Pejës ka publikuar 56 punime të listuara në revista apo botues të dyshimtë. Këto revista kanë qenë të indeksuara në Scopus në kohën e publikimit, por 5 prej revistave (ku janë botuar 25 punime) janë të larguara për çështje të cilësisë në 2015, 2020, 2021 dhe 2023.

Asnjë punim në revista të indeksuara në Web of Science nuk është e listuar si e dyshimtë.

Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë përgjatë viteve



32 profesorë dhe 1 asistent, apo 45% e stafit akademik, kanë publikuar të paktën një herë në revistë apo botues të dyshimtë. Tek stafi me tituj profesorialë kjo përqindje është 51%.

Justifikimi i titujve akademikë


Në këtë kapitull shihet vetëm justifikimi i titujve profesorialë, pra profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent, në raport me numrin e nevojshme të punimeve shkencore për secilën kategori. Për asistentët kjo matje nuk mund të aplikohet pasi për ta nuk kërkohen punime shkencore me rastin e emërimit të tyre.

Justifikimi i titujve në Universitetin e Pejës është i kënaqshëm me 79% të profesorëve që justifikojnë titujt e tyre akademikë. Në të gjitha fakultetet e Universitetit të Pejës rezultati është i barabartë ose në favor të atyre që i justifikojnë titujt akademikë, që kulmon me Fakultetin e Agrobiznesit në të cilin të 93% të profesorëve e tij e justifikojnë titullin e tyre akademikë.


93% e profesorëve asistentë i justifikojnë titujt akademikë, 78% e profesorëve të asocuar, ndërsa 59% të profesorëve të rregullt po ashtu e justifikojnë titullin e tyre akademik. Numri dërrmues i profesorëve asistentë që justifikojnë titullin e tyre akademik tregon zbatimin e ligjshmërisë në proceset e emërimeve të ndjekura gjatë viteve të fundit.

Justifikimi i titujve akademikë sipas fakulteteve dhe titujve akademikë


	Profesorët e rregullt		Profesorët e asocuar		Profesorët asistentë		Të gjithë profesorët	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit	2	2	2	0	5	2	9 69%	4 31%
Fakulteti i Biznesit	2	5	5	1	13	0	20 77%	6 23%
Fakulteti i Agrobiznesit	3	0	5	1	6	0	14 93%	1 7%
Fakulteti Juridik	3	0	2	2	2	0	7 78%	2 22%
Të gjitha fakultetet	**10 59%**	**7 41%**	**14 78%**	**4 22%**	**26 93%**	**2 100%**	**50 79%**	**13 21%**




Përqindja e justifikimit të titujve në **Universitetin e Pejës**




Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit



Fakulteti i Biznesit




Fakulteti i Agrobiznesit



Fakulteti Juridik

Siç mund të vërehet nga grafi i mëposhtëm, në matjen e parë që ka zhvilluar ORCA lidhur me justifikimin e titujve akademikë në këtë universitet në vitin 2020, justifikimi i titujve arrinte në 30% të stafit me tituj profesorialë. Përmbysja e këtij rezultati mund të konsiderohet një rritje tejet domethënëse pasë parasysh që matja e publikuar në këtë raport ka marrë parasysh vetëm punimet e publikuara në revista të idneksuara në Web of Science dhe Scopus, çka nuk ishte rasti në të gjitha vitet paraprake, për shkak të rregullativave të zbatueshme në Kosovë që lejonin për procese të avancimeve akademike edhe publikime në revista të listuara apo indeksuara në platforma tjera.

Justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Pejës përgjatë viteve



Universiteti i Pejës mund të jetë universiteti publik me përmirësimin më të madh të këtij aspekti në Kosovë, çka po reflektohet edhe në suksese tjera akademike siç është arritja e akreditimit të një programi të doktoratës të vlerësuar nga ekspertët e huaj të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Ky moment përbën herën e parë që një universitet tjetër në Kosovë, me përjashtim të Universitetit të Prishtinës të arrijë të akreditojë një program doktorature.

Nga të dhënat e mbledhura vërehet që 92% e grave i justifikojnë titujt e tyre akademikë, krahasuar me 72% të burrave që i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Kjo tregon se diskriminimi sistemik ndaj grave bën që rregullat e vendosura të aplikohen në mënyrë më strikte për gratë në akademi sesa për burrat. Ndonëse kjo është një formë diskriminimi, në të ardhmen kjo do të bëjë që gratë të jenë më kompetente akademikisht dhe në një situatë ku ligjet zbatohen me përpikëri, gratë do të mund të jenë në udhëheqje absolute të arsimit të lartë në Kosovë.


Justifikimi i titujve akademikë sipas gjinisë

	Profesorët e rregullt		Profesorët e asocuar		Profesorët asistentë		Të gjithë profesorët	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Gra	3	0	5	0	14	2	22 92%	2 8%
Burra	7	7	9	4	12	0	28 72%	11 28%
Total	**10**	**7**	**14**	**4**	**26**	**2**	**50**	**13**

92% e grave i justifikojnë titujt akademikë



72% e burrave i justifikojnë titujt akademikë





Metodologjia

Përzgjedhja e stafit akademik
Në muajin dhjetor të vitit 2024 është gjeneruar lista e stafit akademik për secilin fakultet nga uebfaqja zyrtare e Universitetit të Pejës. Për shkak të specifikave të Fakultetit të Arteve, ky fakultet është përjashtuar nga analiza.

Mbledhja e punimeve shkencore
Gjatë muajit janar të vitit 2025, për secilin anëtar të stafit akademik (profesor i rregullt, i asocuar, asistent dhe ligjërues), është krijuar një databazë me punimet shkencore:

- Nëse anëtari i stafit kishte profil në Google Scholar, janë marrë të gjitha punimet nga ky profil.
- Nëse nuk kishte profil, është bërë kërkim me emër në Google Scholar dhe janë përzgjedhur 50 punimet e para për secilin.

Përpunimi i të dhënave bibliografike
Për çdo punim janë evidentuar dhe analizuar këto të dhëna:

- Titulli i punimit, autorët, viti i publikimit, emri i revistës, identifikuesi unik (DOI), botuesi dhe renditja e autorit.
- Numrat ISSN të revistës dhe lloji i publikimit.
- Është kontrolluar nëse revista apo botuesi janë të listuar si të dyshimtë (sipas listës së Beall-it).

Verifikimi i indeksimit

- Është kontrolluar nëse revista ishte e indeksuar në Scopus në vitin e publikimit të punimit.
- Është verifikuar gjithashtu nëse revista bënte pjesë në një nga tre koleksionet kryesore të Web of Science: Science Citation Index Expanded (SCIE), Social Sciences Citation Index (SSCI) dhe Arts & Humanities Citation Index (AHCI).
- Janë shënuar rastet kur revista ishte larguar nga Scopus për arsye të cilësisë.

Përzgjedhja e punimeve të vlefshme
Janë konsideruar të vlefshme vetëm ato punime që:

- Janë artikuj shkencorë të botuar në revista që ishin të indeksuara në Scopus ose Web of Science në kohën e publikimit.
- Nuk janë publikuar në revista apo nga botues të dyshimtë.
- Nuk janë nga revista vendore
- Nuk janë komunikime të shkurta

Analiza dhe kategorizimi
Është realizuar analizë sipas:

- Fakultetit, titullit akademik dhe gjinisë
- Është përllogaritur mesatarja e publikimeve për çdo anëtar të stafit.
- Është analizuar e vlefshmëria e punimeve për avancim akademik bazuar në rolin e autorit (i parë ose korrespodent) dhe nëse janë botuar në revista të indeksuara në Web of Science ose në Scopus në kohën e publikimit.

Analiza e justifikimit të titujve
Në analizën e justifikimit të titujve akademikë është aplikuar ky standard:

- **Profesor i rregullt:** të paktën 5 punime si autor i parë ose korrespodent.
- **Profesor i asocuar**: të paktën 3 punime si autor i parë ose korrespodent.
- **Profesor asistent:** të paktën 1 punim si autor i parë ose korrespodent.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për mitjen e cilësisë në arsim